

**Për zhvillimin e Konkurseve të Pranimit në  
Fakultetin e Studimeve të Inguara me Praktikën  
FASTIP (Durrës)  
Viti akademik 2011 – 2012**

**(R r e g u l l o r e)**

**Kreu 1**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**

**Baza ligjore**

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Kodi i Punës, Kodi i Procedurave Administrative, Ligji për Arsimin e Lartë, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.827, datë 11.06.2008, aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, Statuti i UAMD-së dhe Statuti i Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën janë baza kryesore juridike e kësaj Rregulloreje. Po ashtu edhe aktet e tjera ligjore e nënligjore dhe marrëveshjet ndërkombëtare që kanë efekte në veprimtarinë e FASTIP-it, në kuadrin e kësaj Rregulloreje si dhe në përputhje me bazën kryesore juridike të saj. Udhëzim nr. 22 datë 06/07/2011 ò Per zhvillimin e Konkurseve të pranimit, Tarifën e regjistrimit për konkurrim në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë në institucionet publike të arsimit të lartë; Vendimin nr.13 të datës 16.06.2010 të Këshillit të Fakultetit òPër Kriteret e pranimit të aplikanteve për studentë.

**Neni 2**

**Objekti**

Kjo Rregullore ka për qëllim rregullimin e veprimtarisë së rekrutimit të studentëve pranë Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën, (FASTIP), në përputhje me objektivat dhe misionin ligjor të saj.

### Neni 3

#### Fusha e veprimit

1. Rregullorja për zhvillim e konkurimit të pranimit për studentë e shtrin efektet e saj në strukturën, organet dhe autoritetet drejtuese, personelin akademik, personelin ndihmës-mësimor, personelin administrativ dhe studentët, si dhe çdo personi tjetër fizik apo juridik që vepron në objektet apo territorin e FASTIP-it.
2. Marrëdhëniet me të tretët dhe veprimtaria e tyre në territorin e FASTIP-it, bazohen në aktet ligjore e nënligjore përkatëse ose marrëveshjet e lidhura, por duke iu referuar dispozitave të kësaj rregulloreje, përveç rasteve kur me ligj parashikohet shprehimisht ndryshe.
3. Kjo Rregullore përcakton rregullat e zhvillimit të provimeve në Fakultetin e Studimeve të Integruara me Praktiken.
4. ËKandidatö është individi, që ka fituar Diplomën e Maturës Shtetërore

### Neni 4

1. Konkursit i nënshtrohen të gjithë kandidatët për studentë që kanë rezultuar fitues në formularin A2 të MASH-it,
2. Në programet e studimit të FASTIP të Universitetit të Aleksandër Moisiu të Durrës, rezultatet e shkollës së mesme (nota mesatare e të katër ose pesë viteve të shkollimit dhe katër provimet e Maturës Shtetërore), të llogariten në masën 80%, kurse rezultatet e konkursit të pranimit (Gjuha Angleze) në masën 20 % (pikët minimale për t'u kualifikim do të jenë jenë 40 nga 100 të mundshme).

80% = 80 Pike MASH	20% = 20 Pike FASTIP
--------------------	----------------------

### Neni 5

1. Dekanati shpall në mjedise të dukshme të institucionit deri me datë 11 Gusht 2011, datat dhe oraret e veprimeve të regjistrimit, procedurat përkatëse, listën e dokumentëve të nevojshme për të siguruar një ecuri normale të procesit të regjistrimeve në konkursin e pranimit në ciklin e parë të studimeve me kohë të plotë.
2. Dekanati dhe Përgjegjësitet e Departamenteve janë autoritetet përgjegjëse për zhvillimin e provimit të gjuhës Angleze.

3. Dekanati i Fakultetit merr masa dhe organizon ngritjen e Komisionit të Testimit dhe Vlerësimit të Kandidatëve (KTVK) për Programet përkatëse mësimore. Përbërja e KTVK shpallet një ditë para fillimit të konkurimit përkatës.
4. Komisioni i testimit dhe i vlerësimit të kandidatëve të gjuhës Angleze administron dhe menaxhon procesin.
5. Antarët e komisionit të testimit dhe vlerësimit përzgjidhen nga Dekanati.
6. Komisioni përbehet nga 5 anëtarë: 4 (katër) anëtarë nga stafi akademik dhe 1 (një) anëtar përfaqësues i Biznesit.
7. Në mungesë të anëtarëve të komisionit, Dekanati vendos zëvendësimin e anëtarëve.

#### Neni 6

1. Sekretaria mësimore e Fakultetit, pas verifikimeve të listave të të regjistruarve, me listën e dorëzuar nga Agjencia Kombëtare e Provimeve (AKP) dhe nga MASH-i, në datën 20 Gusht 2011, ora 12 shpall listat e konkurrentëve të regjistruar dhe i afishon ato në vende të dukshme, në mjediset e Fakultetit.
2. Rregjistrimi i kandidatëve për student bëhet në sekretarinë mësimore.
3. Dokumentat që duhet të dorëzohen në sekretari për regjistrim janë:
  - a- Dokument indentifikimi.(Pasaportë ose Kartë indentiteti).
  - b- Mandat arketimi i tarifës së regjistrimit bëhet sipas Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.
4. Në sekretari bëhet tërheqja e materialeve informuese rreth FASTIP-it nga kandidatët për student.
5. Formularin i pagesës tërhiqet në zyrën e financës ose të shkarkohet në web-site të FASTIP-it.

#### Neni 7

1. Konkursi për gjuhën angleze realizohet në ambjentet e FASTIP-it.

2. Datat e zhvillimit të konkursit për programet e Studimit në Fakultetin i Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP ), Durrës, zhvillohen sipas Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.

3 . Shpallja e kandidatëve fitues bëhet 24 orë mbas datës së testimit. Afishimi i listave bëhet në ambientet e Fakulteti si dhe në Web-in e FASTIP-it.

### Neni 8

- Komisioni i testimit dhe i vlerësimit të gjuhës Angleze kryen këto detyra:

1. Komisioni i testimit dhe i vlerësimit në bashkëpunim me sekretarinë afishon në mjediset e fakultetit të gjithë në informacionin e nevojshëm për zhvillimin e provimit të gjuhës Angleze

2. Harton tezën e provimit.

3. Shpall mjedisin ku do të zhvillohet provimi dhe informon çdo kandidat për mjedisin ku do të zhvillohet provimi i gjuhës Angleze.

4. Komisioni vlerëson tezat dhe shpallë fituesit brenda afatit ligjor të përcaktuar në udhëzimin e MASH-it.

### Neni 9

1. Kjo rregullore zbatohet për vitin Akademik 2011-2012.

### Neni 10

1. Kjo rregullore u miratua në mbledhjen e Këshillit të Fakultetit të datës 22/07/2011